



Në bazë të nenit 15.1., 16.3, dhe 16.4.b., dhe 20, të Ligjit për Planifikim të Hapsirës nr. 2003/14, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, nenit 38.1. (b,c,d.) të dhe nenit 81. (h.i.) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështtrim të pikës V. të Vendimit mbi miratimin e Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, nr. 01-17735 të dt. 30.10/2008, dhe Vendimit për qasjen e Plotësimit të Planit Rregullues Urban: "Fidanishte", 01. Nr.7083, të dt. 30.05/2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë 15.07.2011, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Plotësimit e Planit Rregullues Urban: " FIDANISHTE"

1.

Me këtë Vendim, miratohen Plotësimet e Planit Rregullues Urban: "Fidanishte", të Qytetit të Gjilanit, Nr.01.2749, të dt. 16.09/2010, (në tekstin e mëtejshëm: PRRU-"Fidanishte").

2.

Me plotësimet e PRRU nga pika 1. e këtij vendimi është bërë plotësimi i destinimit dhe organizimi i disa përmbajtjeve tjera në disa pjesë të PRRU ekzistues "Fidanishte", në kontekst të kërkesave të pronarëve për ndryshim destinimi si rezultat i procesit të privatizimit të pronave dhe partenriteit publiko-privat si dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale dhe të balancuara të zhvillimit, organizimit hapësinor dhe shfrytëzimit racional të hapësirës, rregullimit të tokës ndërtimore, ndërtimit të objekteve banimore-afariste dhe destinime tjera si dhe ndërtimin e objekteve të infrastrukturës publike dhe infrastrukturës komunale me përmbajtje përcjellëse, me qëllim të krijimit të kushteve dhe për zhvillim të qëndrueshëm, kompakt dhe racional kësaj zone dhe inkorporimin e sajë si pjesë e tërësisë së Qytetit të Gjilanit.

3.

Plotësimet e bëra janë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, nr. 01-17735 të dt. 30.10/2008, dhe duhet të inkorporohen si pjesë përbërse e PRRU: "Fidanishte", Nr.01.2749, të dt. 16.09/2010.

4.

Plotësimet e PRRU, nga pika 1. e këtij vendimi, përmbajnë: Pjesën Tekstuale dhe Pjesën Grafike. Pjesa tekstuale dhe pjesa grafike e planit përmbajnë të gjitha elementet e parapara me Udhëzimin Administrativ për zbatimin e L.P.H. mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05 dhe detyra projektuese e hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, për qasjen e plotësimit të PRRU: "Fidanishte".

5.

Menagjues i Procesit të plotësimit PRRU: Fidanishtë është Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

6.

Hartues i plotësimit dhe harmonizimit të këtij plani, është: NPN: "Favoring", me seli në Prizren.

7.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.

8.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

A rsyetim
i
Vendimit për miratimin e Plotësimit të Planit Rregullues Urban: "Fidanishte"

Kuvendi Komunal në seancën e vetë të mbajtur me datën: 30.05/2011, ka nxjerr Vendimin për miratimin e Plotësimit të Planit Rregullues Urban të lokacionit : "Fidanishte", 01.nr. 16/7083.

Ky plotësim plani, vjen si rezultat i kërkesave të pronarëve-palëve, nga që në procesin e zbatimit praktik, PRRrU: "Fidanishte" ka hasur në disa pengesa të theksuara, si pasojë e kërkesave shtesë të plaëve – pronarëve, të cilët ose nuk kanë qenë të qarta në procesin e debateve publike ose si pasojë e mospjesmarrjes aktive të pronarëve në proces dhe mosedinimi i kërkesave konkrete sidomos në aspekt të destinimit të përmbajtjeve të cilat në mënyrë direkte ose indirekte interferojnë në pronat e tyre, e të cilat shtrihen përgjatë rrugës kryesore, ose si pasojë e procesit të papërfunduar të privatizimit të disa pronave.

Me qëllim të trajtimit të këtyre kërkesave, në kuadër të parametrave të parapar me PZHU dhe PRRrU, më datë 30.05/2011, nga KK-ës Gjilan, është miratuar Vendimi për qasjen e Plotësimit të PrrU: "Fidanishte"

Dejtoria e Urbanizmit në bashkpunim me Hartuesin kam mbajtur takime dhe debate me qytetarët dhe pas analizës së gjendjes dhe harmonizimit të kërkesave, kanë ardhur në përfundim se kërkesat e palëve duhet miratuar pjesërisht duke patur parasysh kriteret dhe parametrat që burojnë nga PZHK dhe PRRrU: "Fidanishte"

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit

Gjilan, Korrik/2011.